



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**BORDI  
VENDIM**

**Nr. 28, Datë 28.02.2019**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SANG 1” SH.P.K.,  
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.02.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr.124 Prot., datë 06.02.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërma “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërma “b” dhe “c”(bilanci financiar i tre viteve të fundit) dhe (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështjetjen financiare të aplikuesit). Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “d” dhe “b” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh / sipas viteve), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, t’i paraqesë ato brënda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë e procedurën për licencimin e Shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM**  
**ANËTARE E BORDIT**  
**ERJOLA SADUSHI**